

UDC 343-8(497.115) “2009/2012”

Phd. Cand. Fatmire Krasniqi¹

**DISA KARAKTERISTIKA TË DËNIMIT ME URDHËR PËR PUNË
NË DOBI TË PËRGJITHSHME SIPAS LEGJISLACIONIT DHE
PRAKTIKËS KOSOVARE**

**НЕКОИ КАРАКТЕРИСТИКИ НА КАЗНАТА СО НАРЕДБА ЗА
РАБОТА ОД ОПШТА ДОБИТ СПОРЕД КОСОВСКАТА
ЛЕГИСЛАТУРА И ПРАКТИКА**

**SOME FEATURES OF THE ORDER FOR COMMUNITY SERVICE
WORK UNDER LEGISLATION AND KOSOVO’S PRACTICE**

Abstract

Punitive policy in report with the lawbreaker, in contemporary periods has suffered many radically changes. Consequently, essential changes of the criminal law reaction, in cases when there is present any legal offense, appeared in punishment’s form and content. Of course, first view is in direction towards realization of reeducation, socialization and reintegration of the lawbreaker and not only the punishment for the fact that in society exists a criminal offense which has been done before.

The trends of findings other forms which will be more suitable for reaction in report with the lawbreaker, especially the trends of deviation from applying the prison punishment, if such a thing is possible, highlights how important are *alternative punishments*. Of course, such punishments are provided and applied in Kosovo’s practice. In this direction, we will try to treat: *alternative punishments* by *Criminal Code of the*

¹ Kandidate e studimeve të Doktoraturës (Phd. Cand), në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, Prishtinë, si dhe *Asistente për grup lëndësh penale* në Universitetin Publik të Gjilanit “Kadri Zeka”, Gjilan.

Republic of Kosovo and their application reasons; *Order for community service work's* notion and its historical presentation aspects; in which circumstances can be applied *Order for community service work* and its application duration; *Order for community service work*, in all Republic of Kosovo's territory during a time period from 2009 to 2012 and also the role of *Kosovo Probation Service* in the process of organization, application and supervision of execution of *order for community service work*.

Key words: *Alternative punishments; Order for community service work; Kosovo Probation Service and Criminal Code of the Republic of Kosovo.*

Hyrje

Përfshirja e personave në aktivitetet kriminale, gjegjësisht sjelljet e tyre anti-sociale të cilat paraprakisht janë të parapara me norma juridiko-penale si vepra penale, obligon organet e drejtësisë në aplikimin e sanksioneve penale ndaj tyre. Mbështetur në të arriturat e fundit në fushën e drejtësisë, sidomos në periudhën bashkëkohore, politika ndëshkimore ndaj personave të tillë, gjithnjë e më tepër është duke u treguar më humane. Një gjë e tillë veçmas vjen në shprehje në formën dhe përmbajtjen e ndëshkimit të zgjedhur për t'u aplikuar ndaj personit si shkelës i normave të tilla juridiko-penale.

Duke vërejtur praktikatat e mëhershme, përkatësisht vështrimi në kontest të përgjithshëm i periudhave kohore më të largëta, ku përmes aplikimit të dënimit ndaj kryesit të sjelljes anti-sociale synohet arritja e qëllimit të shpagimit apo të hakmarrjes ndaj tij, e më konkretisht ku "hakmarrja dhe shpagimi paraqiten si kërkesa të drejtësisë absolute, si domosdoshmëri të drejtësisë hyjnore"², sot çështja e ndëshkimeve ndaj kryesve të veprave penale, pothuajse ka përjetuar një transformim të tërësishëm. Si rezultat i transformimeve të tilla "në lëmin e ekzekutimit të sanksioneve penale, e sidomos të dënimit me burgim, qëllimi i hakmarrjes pothuajse është zbutur dhe si qëllim i fundit, zakonisht trajtohet riintegrimi i personave të dënuar dhe aftësimi i tyre që të kthehen në liri si qytetarë të vjeshëm dhe korrektë"³.

² Ragip Halili, *Penologjia*, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, Prishtinë, 2005, f. 58.

³ Po aty, f. 63.

Mbështetur në të arriturat e tilla si dhe duke pasur parasysh pasojat e mundshme të ndëshkimit në jetën e personit të dënuar, politika e sjelljes në raport me këta persona gjithnjë e më tepër është përmirësuar. Një gjë e tillë reflektohet edhe në tendencat e sotme ku, dënimi në asnjë mënyrë më nuk paraqitet si hakmarrje dhe shpagim, edhe në rrethanat e *kërkesave* për aplikim të tij, megjithatë përtej *kërkesave* të tilla gjithnjë synohet gjetja e një alternative tjetër të zgjedhjes së reagimit të shoqërisë ndaj kryesit të veprës penale. Pra, format e ndryshme të reagimit ndaj kryesve të veprave anti-sociale janë të dukshme thelbësisht, përderisa ngurtësia e ndëshkimit të dikurshëm, ka përjetuar një zbutje *ekstreme* të konsideruar si më dobiprurëse në aspektin e përgjithshëm. Mbështetur në zhvillimet sociale të përgjithshme, gjithsesi edhe shoqëria jonë ka treguar interesim dhe gatishmëri në perfeksionimin e sjelljes ndaj kryesve të veprave penale të cilët kanë rënë në kundërshtim me dispozitat juridiko-penale. Në këtë aspekt, edhe vendi ynë ka treguar tendencë të realizimit të një lufte adekuate kundër sjelljeve kriminale, me qëllim të parandalimit dhe luftimit më efikas të sjelljeve të tilla. Prandaj, konform rregullave të parapara, zhvillimet e deritashme në fushën e drejtësisë, tregojnë ekzistimin e politikës adekuate humane të sjelljes në raport me kryesit e veprave penale, duke u dhënë rëndësi veçmas aplikimit të dënimeve alternative, si formë e zëvendësimit të dënimit me burgim.

Aplikimet e dënimeve alternative, të konsideruara si më efektive në aspektin e riedukimit, risocializimit dhe riintegritimit të personit në shoqëri, kanë gjetur aplikueshmëri të lartë edhe në vendin tonë. Kjo para së gjithash është e shprehur në faktin që, aplikimi i dënimit me burgim të konsiderohet si formë e fundit e reagimit ndaj kryesit të veprës penale, si subjekt shkelës i normave juridiko-penale.

Prandaj, duke parë rëndësinë e këtyre llojeve të dënimeve, e veçmas të *dënimit me urdhër për punë në dobi të përgjithshme*, si një nga llojet e dënimeve alternative, madje me theks të veçantë i trajtuar në këtë hulumtim, do të bëjmë përpjekje që këtë formë ndëshkimore ta trajtojmë më për së afërmi.

Rrjedhimisht, në rend të parë do t'i qasemi trajtimit të llojeve të dënimeve alternative në kuptimin e përgjithshëm sipas *Kodit Penal të Republikës së Kosovës*, për të vazhduar me trajtimin e arsyeve esenciale të aplikimit të këtyre dënimeve si dhe llojeve të tyre. Më tej, duke iu qasur temës bazë do të trajtojmë *dënimin me urdhër për punë në*

dobi të përgjithshme si nocion juridik, por një kujdes të veçantë do t'i kushtojmë edhe historikut të paraqitjes së këtij dënimi. Një vështrim të shkurtër do t'i hedhim edhe arsyeve të shqiptimit si dhe kohëzgjatjes së aplikimit të këtij lloji të dënimit. Me theks të veçantë do të jetë paraqitja numerike e aplikimit të *dënimit me urdhër për punë në dobi të përgjithshme* në tërë territorin e vendit, duke përfshirë të dhënat numerike për kryesit e veprave penale të trajtuar si persona madhorë, por edhe për ata të cilësuar si të mitur. Në fund, do të ndalemi që të trajtojmë çështjet thelbësore që kanë të bëjnë me *Shërbimin Sprovues të Kosovës*, si një nga institucionet më të rëndësishme në fushën e organizimit, zbatimit dhe mbikëqyrjes së aplikimit të *dënimit me urdhër për punë në dobi të përgjithshme*, për tërë territorin e vendit.

1. Dënimet alternative sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe arsyet e aplikimit të tyre

Përcaktimi ligjor i çështjeve që ndërlidhen me proceset e aplikimit të dënimeve në vend, është shumë i qartë. Bazë kryesore e përcaktimeve të tilla, është pikërisht *Kodi Penal i Republikës së Kosovës*. Gjithsesi, në kuadër të këtij *Kodi* janë të radhitura llojet e dënimeve të cilat do të mund të aplikoheshin ndaj kryesve të veprave penale të cilët me sjelljet e tyre bien ndesh me normat juridiko-penale të vendit. Në bazë të përcaktimeve të tilla del se llojet e dënimeve sipas nenit 42 të *Kodit Penal të Republikës së Kosovës* janë: *dënimet kryesore, dënimet alternative dhe dënimet plotësuese*.

Meqenëse bazë kryesore e trajtimit tonë janë pikërisht dënimet alternative, ne do t'u qasemi atyre në aspektin e hulumtimit më të përafërt me qëllim që në të njëjtën kohë atyre t'u dhënë hapësirë më të madhe studimore, përderisa dënimet kryesore dhe dënimet plotësuese do t'i shkëpusim nga një trajtim i tillë.

Sipas *Kodit Penal të Republikës së Kosovës*, dënimet alternative janë lloje të veçanta të dënimeve. Në këtë aspekt, janë paraparë disa lloje të këtyre dënimeve dhe ato janë: *dënimi me kusht, gjysmëliria (semi liberte)* dhe *dënimi me urdhër për punë në dobi të përgjithshme*. Megjithatë, kur organet e drejtësisë shqiptojnë *dënimin me kusht*, përkatësisht kur gjykata e shqipton këtë lloj të dënimit, ajo po ashtu mund të shqiptojë

edhe urdhrin për trajtim të detyrueshëm rehabilitues apo edhe urdhrin për mbikëqyrje nga Shërbimi Sprovues, varësisht nga rrethanat konkrete të rastit të paraqitur⁴.

Dënimi më kusht, sipas dispozitave juridiko-penale paraqet një nga llojet e dënimeve alternative. Natyrisht, një lloj i dënimit të tillë do të shqiptohej nga organet e drejtësisë ndaj kryesit të veprës penale vetëm në rrethanat e parapara me ligj dhe kur një ndërmarrje e veprimit të tillë do të konsiderohej e arsyeshme. Qëllimi esencial në rrethanat konkrete është tentativa e ikjes nga aplikimi i dënimit me burg ndaj një personi si shkelës i rregullave ligjore, kur një gjë e tillë do të ishte e mundshme.

Sipas dispozitave juridiko-penale të *Kodit Penal të Republikës së Kosovës*, “me dënimin me kusht, gjykata ia cakton kryesit të veprës penale dënimin dhe në të njëjtën kohë urdhëron që ky dënim të mos ekzekutohet nëse personi i dënuar nuk kryen veprë tjetër penale për kohën e verifikimit të cilën e cakton gjykata. Koha e verifikimit nuk mund të jetë më e shkurtër se një (1) vit dhe as më e gjatë se pesë (5) vjet”⁵. Pra, sipas rregullës së përcaktuar shihet qartë se në rrethanën konkrete, rëndësi të madhe ka tendenca e ikjes nga aplikimi i dënimit me burgim, gjë që me një veprim të tillë kujdes esencial i kushtohet realizimit të riedukimit të personit dhe dhënies së mundësisë së *pendimit moral* të tij, si rezultat i ndërmarrjes së një sjelljeje të mëparshme të ndaluar në shoqëri. Në të kundërtën, në rrethanat kur një përpjekje e tillë e organeve të drejtësisë do të rezultonte si e pasuksesshme, si rezultat i pamundësisë së realizimit të synimeve ligjore të përcaktuara, mund të shfaqet edhe procesi i revokimit të dënimit me kusht.

Mirëpo, ashtu siç u potencua edhe më lartë, “gjykata mund të shqiptojë dënim me kusht me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues në rast se personi i dënuar e ka shkelur ligjin për herë të parë dhe është i varur nga droga ose alkooli, nëse gjykata, pas shqyrtimit të raportit të Shërbimit Sprovues, konsideron se faktori kryesor që ka motivuar kryerjen e veprës penale është i lidhur me varësinë e tij nga droga ose alkooli dhe se trajtimi i suksesshëm do ta zvogëlonte rrezikun për kryerjen e veprës së re penale. Gjykata cakton periudhën gjatë së cilës programi për trajtim të detyrueshëm duhet të fillojë dhe të përfundojë. Periudha e trajtimit të detyrueshëm nuk mund të jetë më pak se

⁴ Për më tepër shih: *Kodi Penal i Republikës së Kosovës*, Nr.04/L-82, 20 prill 2012, Kapitulli III, Neni 49, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, 1.2 dhe 1.3 si dhe paragrafi 2, nënparagrafi 2.1 dhe 2.2.

⁵ Neni 51, paragrafi 2.

tre (3) muaj apo më tepër se dymbëdhjetë (12) muaj”⁶. Ndërkohë që edhe në rrethanën tjetër, “gjkata mund të shqiptojë dënimin me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga Shërbimi Sprovues nëse konsideron se integrimi i të dënuarit në shoqëri ose përmbushja e kushteve të shqiptuara nga gjykata arrihet më mirë përmes mbikëqyrjes nga ana e Shërbimit Sprovues”⁷. Gjithsesi, edhe çështjet e tjera që ndërlidhen me *urdhrin për trajtim të detyrueshëm rehabilitues* si dhe me *urdhrin për mbikëqyrje nga Shërbimi Sprovues*, janë të përcaktuara më hollësisht me *Kodin Penal të Republikës së Kosovës*.

Gjysmëliria (semi liberte), po ashtu paraqet një nga llojet e dënimeve alternative të përcaktuara në mënyrë të veçantë në *Kodin Penal të Republikës së Kosovës*. Gjithsesi, forma e tillë ndëshkimore e shqiptuar ndaj kryesit të veprës penale, është në favor të tij, duke u mbështetur në mundësitë që organet e drejtësisë i dhënë personit të tillë, sidomos në aspektin e pranisë së tij në jetën sociale në kuptimin parcial kohorë të përcaktuar paraprakisht me rregulla përkatëse, ndonëse i njëjti person konsiderohet shkelës i normave juridiko-pozitive të vendit.

Natyrisht, *Kodi Penal i Republikës së Kosovës* përcakton në mënyrë shprehimore që, “kur shqipton dënimin me burgim deri në një (1) vit, gjykata mund të urdhërojë ekzekutimin e dënimit në gjysmëliri për shkak të detyrimeve të personit të dënuar lidhur me punën, arsimimin ose aftësimin profesional, përgjegjësitë esenciale familjare apo nevojën për trajtim mjekësor ose rehabilitues”⁸. Përcaktimet sipas këtij *Kodi*, të shprehura në dispozitat juridiko-pozitive, vazhdojnë të bëjnë të qartë se, “gjatë vuajtjes së dënimit në gjysmëliri, personi i dënuar detyrohet të kthehet në burg pas kryerjes së detyrimeve jashtë burgut brenda kohës së caktuar nga gjykata”⁹. Duke marrë për bazë rëndësinë e kësaj forme ndëshkimore në raport me kryesin e veprës penale i cili me sjelljet e tij ka rënë në kundërshtim me rregullat juridiko-pozitive të vendit, edhe për këtë formë janë përcaktuar mundësitë e revokimit apo edhe të caktimit të kushteve të tjera ndaj kryesit të veprës penale, të konsideruara si kushte të nevojshme për *rastin penal* të paraqitur.

Dënimi me urdhër për punë në dobi të përgjithshme, sipas *Kodit Penal të Republikës së Kosovës* paraqet një prej llojeve të dënimeve alternative. Gjithsesi, forma

⁶ Neni 57, paragrafi 1.

⁷ Neni 58, paragrafi 1.

⁸ Neni 61, paragrafi 1.

⁹ Neni 61, paragrafi 2.

dhe përmbajtja e këtij dënimi alternativ, vështruar në aspektin komparativ me llojet e tjera të dënimeve paraqet një etapë më të lartë në aspektin e humanizimit të politikës ndëshkimore ndaj kryesve të veprave penale. Shqiptimi i *dënimit me urdhër për punë në dobi të përgjithshme*, vështruar në aspektin përmbajtësor paraqet formë më të avancuar të tendencës së organeve të drejtësisë që kryesi i veprës penale i konsideruar si shkelës i rregullave juridiko-pozitive të vendit, të arrijë riedukim adekuat. Realisht, dënimi i tillë alternativ paraqet bazën studimore në të cilën do të mbështetemi gjatë gjithë këtij rrugëtimi hulumtues. Rrjedhimisht, sipas *Kodit Penal të Republikës së Kosovës*, meqenëse fillesat e hulumtimit tonë i përqendruam në dispozitat e këtij *Kodi* dhe meqenëse pikërisht ky *Kod* është baza esenciale e përcaktimeve juridike të çështjeve nga fusha penale, pikërisht në të gjejmë elementet esenciale edhe për këtë formë ndëshkimore. Në këtë aspekt përcaktohet se, “gjykata mund t’ia shqiptojë personit të dënuar dënimin me urdhër për punë në dobi të përgjithshme nëse kryesit i shqipton dënim me gjobë deri në dy mijë e pesëqind (2.500) Euro ose me burgim deri në një (1) vit. Puna në dobi të përgjithshme mund të caktohet vetëm me pëlqimin e personit të dënuar”¹⁰. Natyrisht, në rastet e shqiptimit të këtij dënimi alternativ personi i dënuar do të duhet të kryej punë në dobi të përgjithshme dhe pa pagesë. Me aplikimin e dënimit të tillë, konsiderohet se në njërin anë do të fitojë shoqëria përkatëse në favor të së cilës do të kryhen punë me interes të caktuar, por në anën tjetër nga ushtrimi i këtyre punëve do të fitojë edhe subjekti i ndëshkuar, ku synimet orientohen sidomos në riedukimin e tij, krijimin e shprehive përkatëse të punës si dhe aftësimin e tij në ndonjë profesion.

Në këtë drejtim, *Kodi Penal i Republikës së Kosovës*, përmes përcaktimeve të dënimeve alternative përkrah llojeve të tjera të dënimeve, ka përcjellë në mënyrë shprehimore aspektin e humanitetit dhe respektimit të të drejtave esenciale të subjekteve të së drejtës, duke përcaktuar kufizimin e tyre vetëm në rrethanat e domosdoshme. Arsyeshmëria e aplikimit të dënimeve alternative është në rend të parë tendencë e realizimit të shmangies së aplikimit të dënimit me burgim ndaj kryesve të veprave penale. Përtej kësaj, “sipas disa hulumtimeve që janë bërë, aplikimi i dënimeve alternative, si supstitute (zëvendësim) i dënimit me burgim, përveç anëve të tjera pozitive, në aspektin

¹⁰ Neni 60, paragrafi 1.

material është dybëdhjetë herë më i lirë se aplikimi i dënimit me burgim”¹¹. Gjithsesi, aplikimi i dënimeve alternative mund të arsyetohet edhe për qëllime të tjera, ndër të cilat me rëndësi esenciale është fakti që përmes aplikimit të tyre, synohet arritja e riedukimit adekuat të personave, dhënia e mundësisë që të njëjtit *moralisht* të pendohen dhe që në të ardhmen mos të përsërisin sjelljet e tyre anti-sociale, e ndonjëherë edhe aftësimi i tyre në ndonjë profesion të caktuar si dhe realizimi i mosshkëputjes nga ambienti jetësor, në të cilin ata kanë jetuar më parë. Natyrisht, rol të madh në aspektin e realizimit të synimeve përkatëse në raport me kryesit e veprave penale, shpalosin edhe mundësitë e aplikimeve të detyrimeve të veçanta, ku gjithsecila prej tyre në vete përfshinë aspekte të larta pozitive në interes të personit në fjalë.

2. Nocioni i dënimit me urdhër për punë në dobi të përgjithshme dhe aspektet historike të paraqitjes së tij

Aspektet e përgjithshme përcaktuese të nocionit themelorë të dënimit alternativ në formën e *dënimit me urdhër për punë në dobi të përgjithshme*, janë përcaktuar tashmë. Në këtë kuptim, një gjë e tillë është përcjellë edhe më lartë, duke u mbështetur pikërisht në dispozitat juridiko-penale të *Kodit Penal të Republikës së Kosovës*, si akt themelor juridik në fushën penale. Megjithatë, pavarësisht këndeve të ndryshme të trajtimit të këtij dënimi, baza përcaktuese e tij mbetet e njëjtë. Pra, nocioni bazë i përcaktuar do të nënkuptonte atë se, dënimi alternativ i formës së *dënimit me urdhër për punë në dobi të përgjithshme*, është dënim alternativ të cilin e shqipton gjykata pas dhënies së pëlqimit nga personi i dënuar dhe pas shqyrtimit të raportit të Shërbimit Sprovues, më konkretisht “gjykata e urdhëron personin e dënuar të kryejë pa pagesë, punë në dobi të përgjithshme për një periudhë të caktuar prej tridhjetë (30) deri në dyqind e katër dhjetë (240) orë pune”¹². Sidoqoftë, për të bërë edhe më të qartë nocionin kuptimor të këtij dënimi mund të potencohet edhe një aspekt tjetër i rëndësishëm. Në këtë kuptim, “puna në dobi të përgjithshme si dënim alternativ konsiston në atë që me aktgjykim të gjykatës, kryesit të

¹¹ Dr. Ismet Salihu, *E drejta penale-pjesa e përgjithshme*, Universiteti Fama, Fakulteti Juridik, Prishtinë, 2008, f. 459.

¹² Për më tepër shih: *Kodi Penal i Republikës së Kosovës*, Nr.04/L-82, 20 prill 2012, Kapitulli III, Neni 60, paragrafi 2.

veprës penale i caktohet obligimi që brenda afatit të caktuar të kryejë punë në dobi të përgjithshme, në interes publik”¹³. Natyrisht, në rrethanat e realizimit të synimeve të përmbushjes së obligimeve të marra nga kryesi i sjelljes së ndaluar në shoqëri, rol të rëndësishëm ka edhe *Shërbimi Sprovues i Kosovës*, si urë ndërlidhëse në mes të organeve përkatëse të drejtësisë (si organe legjitime të shqiptimit të llojeve të tilla të ndëshkimit) si dhe subjektit ndaj të cilit aplikohet një ndëshkim i tillë. Pra, roli esencial i Shërbimit Sprovues të Kosovës është në aspektin e mbikëqyrjes dhe përcaktimit të programeve të përshtatjes së punës në dobi të përgjithshme me aspektet personale dhe përgatitore të kryerësit të veprës penale, i cili do të duhet ta përmbushë këtë punë.

Sa i përket aspektit historik të paraqitjes së *dënimit me urdhër për punë në dobi të përgjithshme*, konsiderohet se, “ky lloj i dënimit alternativ, i cili emërtohet edhe si punë e dobishme shoqërore apo në interes publik (community service), parashihet në shumicën e legjislacioneve penale bashkëkohore. Për herë të parë ky dënim është paraparë në Angli më 1972 (Criminal Justice Code 1972)”¹⁴, ndërkohë që “më pas, këtë lloj dënimi e kanë përvetësuar edhe shumë shtete të tjera të zhvilluara të Evropës, siç është Franca, Finlanda, Çekia, Suedia, Anglia, Irlanda e Veriut etj.. Gjithashtu, puna në dobi të përgjithshme është paraparë edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës”¹⁵.

Rrjedhimisht, duke parë efektet pozitive në shumë drejtime, të shfaqura nga procesi i aplikimit të këtij dënimi ndaj kryesve të veprave penale, çështja e aplikimit të këtij lloji të dënimit alternativ, gjithsesi gjeti përkrahje edhe në vendin tonë. Është pikërisht një nga llojet e dënimeve që përmes aplikimit të tij, synohet të përcillen efektet përmirësuese të gjithanshme të subjektit ndaj të cilit aplikohet ky dënim. Në këtë kuptim, lloji i tillë i dënimit është përcaktuar veçmas në *Kodin Penal të Republikës së Kosovës*, ku në mënyrë të qartë përcillen çështjet që kanë të bëjnë me rastet se, kur mund të caktohet një dënim i tillë, kohëzgjatjen e tij, revokimin apo në rrethana të arsyeshme edhe zëvendësimin e tij me dënimin me burgim. Ndërsa, sa i përket aspektit që ka të bëjë veçanërisht me mënyrën e ekzekutimit të *dënimit me urdhër për punë në dobi të*

¹³ Dr. Ismet Salihu, *E drejta penale-pjesa e përgjithshme*, Universiteti Fama, Fakulteti Juridik, Prishtinë, 2008, f. 482.

¹⁴ M. Babiç, *Alternative kazni zatvora u cilju efikasniye borbe protiv kriminaliteta*, JRKK, nr. 2-3, Beograd, 1997, f. 136. (Cit. sipas: Dr. sc. Rexhep Gashi, *Ekzekutimi i dënimeve alternative*, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, Prishtinë, 2013, f. 99).

¹⁵ Dr. Ismet Salihu, vep. e cit., f. 481.

përgjithshme, programit përmbajtësor të punës në dobi të përgjithshme si dhe mbikëqyrjes së aplikimit të këtij programi, në mënyrë esenciale një gjë e tillë është rregulluar edhe me *Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale të Republikës së Kosovës, me Nr. 04/L-149*. Realisht, me këtë *Ligj* janë të rregulluara edhe aspekte të tjera të ndërlidhura drejtpërdrejt me këtë lloj të dënimit alternativ. Prandaj, përmes përcaktimeve të tilla në mënyrë të qartë vihet në dukje roli dhe rëndësia e këtij dënimi në sistemin ndëshkimor në tërësi në vendin tonë, duke synuar gjithnjë e më tepër arritjen e politikës ndëshkimore sa më humane.

3. Rrethanat në të cilat mund të shqiptohet dënimi me urdhër për punë në dobi të përgjithshme dhe kohëzgjatja e aplikimit të tij

Reagimi i shoqërisë ndaj sjelljeve të ashtuquajtura sjellje anti-sociale, ashtu siç e potencuam edhe më parë, ka përjetuar një zhvillim me elemente pozitive të shumta. Përderisa në periudhat e mëhershme kohore reagimi shoqëror ka qenë në formën më të lartë represive, politika ndëshkimore e sotme është *mbuluar* pothuajse e tëra nga aspekti i humanitetit, në raport më shkelësin e normave juridiko-penale në shoqëri. Deri te një rezultat i tillë i sjelljes, rol esencial kishin zhvillimet e vazhdueshme në shoqëri, gjë që përcollën ndikimet e tyre edhe në sferën penale. Veçmas në këtë aspekt mund të potencohet se, “parimi i përcaktueshmërisë së veprës penale dhe të sanksionit penal me ligj, paraqet njërën prej karakteristikave themelore të së drejtës penale bashkëkohore”¹⁶. Mbështetur në përcaktueshmëritë e tilla, aplikimi i dënimeve alternative merr formë dhe përmbajtje të veçantë në aspektin e mundësisë së shqiptimit nga ana e organeve të drejtësisë. Rrjedhimisht, duke u konsideruar që, “çështje kryesore e së drejtës penale janë sanksionet penale”¹⁷, përcaktimet e dënimeve alternative shpalosin humanitetin e forcuar

¹⁶ Mr. sc. Bajram Ukaj, *Parimi i ligjshmërisë, E drejta*, Nr. 1-2, Revistë për çështje juridike dhe shoqërore, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, Prishtinë, 2002, f. 69.

¹⁷ Haki Lecaj, *E drejta penale, Doracak për përgatitjen e provimit të jurisprudencës*, Botimi i tretë, Implementuar nga UNDP-Kosovë, Prishtinë, 2008, f. 243.

të kësaj të drejte gjithnjë e më tepër ndaj subjekteve themelore të procedurës penale, e veçmas ndaj kryesit të sjelljes anti-sociale.

Shqiptimi i *dënimit me urdhër për punë në dobi të përgjithshme*, mund të bëhet vetëm duke u mbështetur në dispozitat ligjore. Sipas dispozitave të tilla, të studiuara edhe nga ekspertë të fushës përkatëse, ashtu siç e potencuam edhe më parë del se, “Gjykata mund t’ia shqiptojë personit të dënuar dënimin me urdhër për punë në dobi të përgjithshme nëse kryesit i shqipton dënim me gjobë deri në dymijë e pesëqind (2.500) Euro ose me burgim deri në një (1) vit. Puna në dobi të përgjithshme mund të caktohet vetëm me pëlqimin e personit të dënuar”¹⁸. Natyrisht, plotësimi i kushteve të tilla ofron mundësi të fuqishme drejt aplikimit të këtij lloji të dënimit.

Sa i përket kohëzgjatjes së *dënimit me urdhër për punë në dobi të përgjithshme*, një gjë e tillë po ashtu është e përcaktuar me dispozita ligjore. Rrjedhimisht, si rregull e përgjithshme përcaktohet që, “puna në dobi të përgjithshme kryhet brenda një periudhe kohore të përcaktuar nga gjykata, e cila nuk e tejkalon një (1) vit”¹⁹. Sa u përket personave, të cilësuar si madhorë dhe të cilët konsiderohen se paraqesin subjekte themelore të procedurës penale, ndaj të cilëve gjykata përcakton masën ndëshkimore në formën e *dënimit me urdhër për punë në dobi të përgjithshme*, përcaktuar në dispozitat ligjore të *Kodit Penal të Republikës së Kosovës*, ndër të tjera del se, “nëse e shqipton dënimin me urdhër për punë në dobi të përgjithshme, gjykata e urdhëron personin e dënuar të kryejë pa pagesë, punë në dobi të përgjithshme për një periudhë të caktuar prej tridhjetë (30) deri në dyqind e dyzet (240) orë pune. Shërbimi Sprovues vendos për llojin e punës në dobi të përgjithshme që duhet të kryhet nga personi i dënuar, cakton organizatën e veçantë për të cilën personi i dënuar do të kryejë punën në dobi të përgjithshme, vendos për ditët e javës gjatë të cilave puna në dobi të përgjithshme duhet të kryhet dhe mbikëqyrë kryerjen e punës në dobi të përgjithshme”²⁰.

Ndërkohë që, *dënimi me urdhër për punë në dobi të përgjithshme*, mund të shqiptohet edhe ndaj personave të mitur. Megjithatë, dallimi esencial sa i përket aplikimit të këtij dënimi në krahasim me personat madhorë, shfaqet pikërisht në kohëzgjatjen e shqiptimit të dënimit në fjalë. Prandaj, “kur e shqipton urdhrin për punë në dobi të

¹⁸ *Kodi Penal i Republikës së Kosovës*, Nr.04/L-82, 20 prill 2012, Kapitulli III, Neni 60, paragrafi 1.

¹⁹ Neni 60, paragrafi 3.

²⁰ Neni 60, paragrafi 2.

përgjithshme, gjykata e urdhëron të miturin që të kryejë punë në dobi të përgjithshme pa pagesë për një afat të caktuar prej tridhjetë (30) deri në njëqind e njëzet (120) orë. Shërbimi Sprovues e përcakton llojin e punës në dobi të përgjithshme të cilën duhet ta kryejë personi i dënuar, cakton organizatën specifike për të cilën personi i dënuar do ta kryejë punën në dobi të përgjithshme, vendosë për ditët e javës kur do të kryhet puna dhe mbikëqyrë kryerjen e punës në dobi të përgjithshme²¹. Pra aspekti i përgjithshëm dallues sa i përket këtij lloji të dënimit, të aplikuar ndaj personave madhorë dhe ndaj të miturve, është në kuptimin e kohëzgjatjes së dënimit të tillë i cili del të jetë për gjysmë më i shkurtër se të miturit.

4. Dënimi me urdhër për punë në dobi të përgjithshme, në tërë territorin e Republikës së Kosovës gjatë periudhës kohore 2009-2012

Dënimi me urdhër për punë në dobi të përgjithshme, i trajtuar si dënim më i butë dhe veçanërisht si një lloj i zëvendësimit të dënimit me burgim, sipas normave juridiko-pozitive në vend, mund të aplikohet ndaj kryesve të veprave penale, të cilësuar si persona madhorë por edhe ndaj kryesve të veprave penale të cilësuar si të mitur.

Arsyeshmëria e trajtimit të aspekteve numerike në kuptim të radhitjes dhe paraqitjes së tyre, në rend të parë për personat madhorë dhe më pas për personat e mitur, ishte për faktin që, në të gjitha rrethanat numri i personave madhorë si kryes të sjelljeve anti-sociale në krahasim me të miturit, ishte gjithmonë më i lartë. Prandaj, numri i të miturve ndaj të cilëve janë shqiptuar vendimet gjyqësore me përmbajtje të dënimeve përkatëse, në krahasim me personat madhorë ishte shumë më i vogël, dhe që kushtimisht mund të themi se shifrat numerike që kanë të bëjnë me personat e mitur, mbeten nën *hijën* e numrit tejet të lartë të sjelljeve anti-sociale të personave madhorë, e që rezulton edhe më një numër të lartë të dënimeve të shqiptuara ndaj tyre.

Për periudhën kohore të përcaktuar në hulumtimin tonë, *dënimi me urdhër për punë në dobi të përgjithshme* në bazë të të dhënave statistikore në të cilat e kemi mbështetur këtë hulumtim, del se ka gjetur aplikueshmëri të një niveli të lartë. Madje, një

²¹ *Kodi i drejtësisë për të mitur*, Nr. 03/L-193, 8 korrik 2010, Kreu VI, Neni 31, paragrafi 2.

gjë e tillë mund të potencohet për faktin që, duke vështuar të dhënat numerike, veçanërisht në aspektin komparativ, mund të themi se *dënimi me urdhër për punë në dobi të përgjithshme*, ndër vite ka shënuar rritje graduale por megjithatë jo shumë të theksuar.

Duke e ditur se, “Shërbimi Sprovues i Kosovës është institucion kompetent për ekzekutimin e masave dhe dënimeve alternative”²², po ashtu ne zgjedhëm që të dhënat numerike në lidhje me aplikimin e *dënimit me urdhër për punë në dobi të përgjithshme* t’i paraqesim pikërisht sipas të dhënave numerike të publikuara nga ky *Shërbim*. Në këtë drejtim, të dhënat statistikore për tërë territorin e vendit, do t’i përcjellim në vazhdim.

Tabela 1 . Shqiptimi i dënimeve për persona madhorë dhe të mitur gjatë viteve 2009, 2010, 2011 dhe 2012²³

Shqiptimi i dënimit me urdhër për punë në dobi të përgjithshme në tërë territorin e Republikës së Kosovës				
Nr. i rasteve për:	Periudha kohore			
	2009	2010	2011	2012
Persona madhorë	35	113	110	131
Persona të mitur	18	208	29	16

Mbështetur në të dhënat statistikore të përcjella në tabelën e mësipërme, bëhet e qartë se gjatë periudhës kohore të vitit **2009**, *dënimi me urdhër për punë në dobi të përgjithshme*, ishte aplikuar në një shifër të lartë ndaj personave madhorë por edhe ndaj personave të mitur. Megjithatë në bazë të të dhënave tabelare, *dënimi me urdhër për punë në dobi të përgjithshme* siç shihet ishte më shumë i aplikuar te personat e madhorë.

Ndërkohë që, edhe periudha kohore e vitit **2010** karakterizohet me numër të lartë të pranisë së veprave penale. Prandaj edhe numri i personave të dënuar me *dënimin me urdhër për punë në dobi të përgjithshme* rezulton të jetë shumë i lartë. Megjithatë, të dënuar për sjelljet anti-sociale janë edhe një numër i konsiderueshëm i personave të

²² Shërbimi Sprovues i Kosovës, *Buletini nr.5, Hulumtim analitiko-empirik i faktorëve të përgjithshëm që shkaktojnë delikuentën te të miturit përmes studimit të veprimtarisë dhe punëve të Shërbimit Sprovues të Kosovës*, Ministria e Drejtësisë, Prishtinë, 2010, f. 29.

²³ Për më tepër shih: Shërbimi Sprovues i Kosovës, *Buletinët Nr. 5-8*, për vitet 2010-2013, Ministria e Drejtësisë, Prishtinë.

mitur, të cilët madje në bazë të të dhënave të mësipërme prijnë për nga shkalla e aplikueshmërisë së *dënimit me urdhër për punë në dobi të përgjithshme*, ndaj tyre.

Viti vijues, më konkretisht periudha kohore e vitit **2011**, po ashtu karakterizohet me një numër të lartë të dënimeve të shqiptuara, qoftë ndaj personave madhorë e po ashtu edhe ndaj personave të mitur. Rrjedhimisht, sipas të dhënave tabelare të prezantuara më lartë, *dënimi me urdhër për punë në dobi të përgjithshme* gjen aplikueshmëri të theksuar, por megjithatë, në këtë periudhë kohore më i aplikuar mbetet ndaj personave madhorë si kryerës të sjelljeve anti-sociale.

Shifra numerike që tregojnë praninë e sjelljeve anti-sociale në tërë vendin gjatë periudhës kohore të vitit **2012**, madje shifra tejet të larta dalin edhe sipas të dhënave tabelare të shpalosura më lartë, për periudhën kohore të vitit 2012. Në këtë drejtim, karakteristikë del të jetë fakti që në aspektin numerik gjatë kësaj periudhe kohore, sa i përket numrit të shqiptimit të *dënimit me urdhër për punë në dobi të përgjithshme* prijnë personat madhorë në krahasim me personat e mitur.

5. Roli i Shërbimit Sprovues të Kosovës në procesin e organizimit, zbatimit dhe mbikëqyrjes së ekzekutimit të *dënimit me urdhër për punë në dobi të përgjithshme*

Shërbimi Sprovues i Kosovës në aspektin e organizimit, zbatimit dhe mbikëqyrjes së ekzekutimit të dënimeve alternative, paraqet institucionin kryesorë në vend. Realisht, në mënyrë të qartë përcaktohet se *Shërbimi Sprovues i Kosovës*, “është përgjegjës për ekzekutimin e dënimeve dhe masave alternative, mbikëqyrjen, risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin e të gjithë personave që kanë kryer vepra penale të ndëshkueshme sipas ligjeve të aplikueshme në Republikën e Kosovës”²⁴.

Në këtë drejtim, shkurtimisht do të përcjellim vetëm një pjesë të funksioneve të *Shërbimit Sprovues të Kosovës*, për faktin që, synimet bazë i kemi të përqendruara në rolin dhe rëndësinë e këtij *Shërbimi* në aspektin e të gjitha çështjeve që ndërlidhen me *dënimin me urdhër për punë në dobi të përgjithshme*.

Kur trajtojmë *dënimin me urdhër për punë në dobi të përgjithshme*, roli dhe rëndësia e *Shërbimit Sprovues të Kosovës* është shumë e theksuar. Kjo mbase duke pasur

²⁴ Për më tepër shih: www.md-ks.org/?page=1,31.

parasysh edhe natyrën specifike të këtij dënimi në raport me llojet e dënimeve të tjera, qofshin ato dënime të formave dhe përmbajtjeve të tjera të përcaktuara me dispozita juridiko-pozitive, qofshin ato të llojeve të tjera të dënimeve alternative, gjithashtu të përcaktuara me dispozitat e të njëjtit lloj. Megjithatë, përcaktohet që, “kur gjykata shqipton dënimin me urdhrin për punë në dobi të përgjithshme, sipas dispozitave të *Kodit Penal të Kosovës*, ajo ia dërgon menjëherë aktgjykimin me të gjitha të dhënat që i posedon Shërbimit Sprovues kompetent për ekzekutimin e këtij dënim alternativ”²⁵.

Ndërkohë që, rolin dhe rëndësinë e madhe të këtij *Shërbimi* veçmas e përcaktojnë shprehimisht dispozitat ligjore të mëposhtme ku ndër të tjera përcaktohet se, “1. Shërbimi Sprovues e zhvillon programin për punë në dobi të përgjithshme për personin e dënuar në pajtim me dispozitat e *Kodit Penal të Kosovës* dhe bazuar në aftësitë, shkathtësitë dhe të kaluarën e tij; 2. Shërbimi Sprovues e mbikëqyrë ekzekutimin e dënimit me urdhër për punë në dobi të përgjithshme; 3. Shërbimi Sprovues, në bashkërendim me organizatën ku duhet kryer puna në dobi të përgjithshme, vendosë rregullat e sigurimit për rastet e lëndimeve në vendin e punës, ose sëmundjes, sjelljen e përgjithshme në vendin e punës dhe çështjet tjera përkatëse para fillimit të punës në dobi të përgjithshme. Akti nënligjor për orarin e punës, pushimet, pushimet javore dhe mbrojtjen në vendin e punës zbatohen gjatë punës në dobi të përgjithshme”²⁶. Në të njëjtën kohë, “kur gjykata shqipton dënimin me urdhër për punë në dobi të përgjithshme dhe personin e dënuar e urdhëron që të kontaktojë me Shërbimin Sprovues, apo të përmbushë një, ose më shumë obligime sipas dispozitave të *Kodit Penal të Kosovës*, Shërbimi Sprovues e mbikëqyrë mbajtjen e kontaktit, apo përmbushjen e obligimit”²⁷.

Natyrisht, *Shërbimi Sprovues i Kosovës*, në procesin e realizimit të obligimeve ligjore, ka bashkëpunuar dhe bashkëpunon me një numër të madh të organizatave dhe institucioneve publike, të cilat ndodhen jo vetëm në *Regjionin e Prishtinës* por edhe në regjionet e tjera të tërë territorit të vendit. Në këtë drejtim, bashkëpunimet më të theksuara janë me: *Shërbimin e zjarrfikësve dhe shpëtimit (Prishtinë)*, *Kompaninë e*

²⁵ *Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale*, Ligji me nr. 04/L-149, 29 korrik 2013, Kreu VIII, Neni 151, paragrafi 1.

²⁶ Neni 152, paragrafi 1, 2 dhe 3.

²⁷ Neni 153, paragrafi 1.

*ujësjellësit rajonal "Prishtina" (Prishtinë), Shtëpinë e Kulturës (Lipjan), Qendrën e Aftësimi Profesional (Pejë) etj.*²⁸.

Realisht, të drejtat dhe detyrimet e *Shërbimit Sprovues të Kosovës* në rrethanat e ekzistimit të *dënimit me urdhër për punë në dobi të përgjithshme* janë të mëdha. Madje, të drejtat dhe detyrimet e tilla, të ushtruara sipas përcaktimeve ligjore nga ky *Shërbim*, janë me një rol të drejtpërdrejtë në kuptim të risocializimit, riedukimit dhe riintegritit të mirëfilltë të personave të dënuar nga organet e drejtësisë. Natyrisht, organizimi dhe bashkëpunimi i institucioneve relevante në vend, zbatimi i dënimeve alternative në formën e përcaktuar ligjore, përmbushja e obligimeve ligjore të përcaktuara për këtë institucion si dhe procesi funksional mbikëqyrës i këtij institucioni, luajnë një rol pozitiv në të gjitha dimensionet e realizimit të politikës ndëshkimore sa më humane, në raport me kryesit e veprave penale. Mbi të gjitha, "ky shërbim, si i vetmi i këtij lloji në rajon, mund të shërbejë si model për krijimin e shërbimeve sprovuese të vendeve tjera të rajonit"²⁹.

6. Conclusion

By observing the specific natyre of the *alternative punishment*, presented in the form of *Order for community service work*, our purposes were directed in the aspect of treating this form of punishment in many dimensions. Really, we supported the essential basis of such a treatment in the meaning of presenting numerical datas on this punishment's applicability level in all Republic of Kosovos's territory, during the period from 2009 to 2012.

To achieve a close understanding with the presented datas, we chose a treatment form that we considered it to be more special. In this sense, first we focused on presenting the general datas that are related with all sorts of *alternative punishments*, treated and determined according to the *Criminal Code of the Republic of Kosovo*, and then we showed the fundamental notion of the *Order for community service work*, but in

²⁸ Shërbimi Sprovues i Kosovës, *Buletini 2007*, f. 8-10, (Cit. sipas Dr. sc. Rexhep Gashi, *Ekzekutimi i dënimeve alternative*, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, Prishtinë, 2013, f. 108-112).

²⁹ Dr. sc. Rexhep Gashi, *Shërbimi Sprovues i Kosovës: historiku, fushëveprimi, organizimi dhe aktiviteti i tij, E drejta*, Revistë për çështje Juridike dhe shoqërore, Viti XXXIII-nr. 3-4/2008, Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës, Prishtinë, 2008, f. 30.

the same time trying to show the short historical of the appearance and essential origin of this punishment form.

Consequently, during the treatment of such a theme, we came in some conclusions. In this direction, *Order for community service work*, revealed a step towards strengthening a more human punishment politics against the rule breakers. By all means, such a thing has been accepted in our society too, while such punishment form is foreseen and regulated in a special way also with the *Criminal Code of the Republic of Kosovo*. With a special emphasis, at such punishment law experts saw many positive sides, in circumstances of its application and execution. This is especially due for the fact that, applying such a punishment is cheaper than applying a punishment with prison and also *the benifites* by applying such a punishment are very high. Such a thing is seen especially in: **social benifits** (for the fact of execution of the order for community service work and free of charge) and **individual benifits** (for the fact that the convicted person is educated professionally, in any assigned profession; is reeducated much more easily; wins work habits in case of absence of such habits; is not separated from the environment in which he/she lived untill he/she broke the legal-criminal rules and above all, is achieved an avoiding from the possible labelings of the mentioned person).

Of course, in the last part we dedicated also a great care towards the role and importance of *Kosovo Probation Service* in the organizing aspect, application and supervision of the execution of *order for community service work*.

Finally we can say that, the *Order for community service work* is being applied by judicial bodies in our country too. However, regarding the numerical datas presented in this project, it becomes clear that the, adults are the most rule-breakers comparing with underage persons, but also the *Order for community service work* continues to be more applicable towards adults.

Natyrally we evaluate that, considering the positive sides of the *Order for community service work*, it should be given priority in all circumstances of possible punishment alternatives, to this kind of punishment as a replacement to the punishment with prison. It's important that, from year to year is seen the increase of the number of judicial decisions with the punishment content of *Order for community service work*. Anyhow, all hopes remain in achieving the adjusment of a such punishment against the

convicted person, in order that the same person gets the right reeducation and from the negative case shown, to tend to smooth the circumstances of the reaction and to gain more favorable benefits for all.

Prishtinë,
maj 2015

Literatura

Libra dhe artikuj shkencorë

1. Gashi, Rexhep, *Ekzekutimi i dënimeve alternative*, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, Prishtinë, 2013;
2. Gashi, Rexhep, *Shërbimi Sprovues i Kosovës: historiku, fushëveprimi, organizimi dhe aktiviteti i tij, E drejta*, Revistë për çështje Juridike dhe shoqërore, Viti XXXIII-nr. 3-4/2008, Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës, Prishtinë, 2008;
3. Halili, Ragip, *Penologjia*, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, Prishtinë, 2005;
4. Lecaj, Haki, *E drejta penale, Doracak për përgatitjen e provimit të jurisprudencës*, Botimi i tretë, Implementuar nga UNDP-Kosovë, Prishtinë, 2008;
5. Salihu, Ismet, *E drejta penale-pjesa e përgjithshme*, Universiteti Fama, Fakulteti Juridik, Prishtinë, 2008;

6. Ukaj, Bajram, *Parimi i ligjshmërisë, E drejta*, Nr. 1-2, Revistë për çështje juridike dhe shoqërore, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, Prishtinë, 2002.

Akte ligjore dhe burime të tjera

1. Shërbimi Sprovues i Kosovës, *Buletini nr. 8*, Ministria e Drejtësisë, Prishtinë, 2013;
2. Shërbimi Sprovues i Kosovës, *Buletini nr. VII*, Ministria e Drejtësisë, Prishtinë, 2012;
3. Shërbimi Sprovues i Kosovës, *Buletini nr.5, Hulumtim analitiko-empirik i faktorëve të përgjithshëm që shkaktojnë delikuecën te të miturit përmes studimit të veprimtarisë dhe punëve të Shërbimit Sprovues të Kosovës*, Ministria e Drejtësisë, Prishtinë, 2010;
4. Shërbimi Sprovues i Kosovës, *Buletini nr.6*, Ministria e Drejtësisë, Prishtinë, 2011;
5. *Kodi i drejtësisë për të mitur*, Nr. 03/L-193, 8 korrik 2010;
6. *Kodi Penal i Republikës së Kosovës*, Nr.04/L-82, 20 prill 2012;
7. *Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale*, Ligji me nr. 04/L-149, 29 korrik 2013;
8. www.md-ks.org/?page=1,31.

